



Academy of Central
European Schools

16.01.2015

Ftohen shkollat në Republikën e Kosovës për të marrë pjesë në Akademinë e Shkollave të Evropës Qendrore (ACES)

Tema e garës për vitin 2015: "Solidariteti"

Ftohen shkollat në Republikën e Kosovës të marrin pjesë në konkursin ndërkombëtar të organizuar nga Akademia e Shkollave të Evropës Qendrore (ACES), një nga rrjetet më të mëdha shkollore në Evropën Qendrore dhe Juglindore, e cila u ofron mundësi mësuesve dhe nxënësve për të takuar kolegë nga vende të tjera, të ndajnë përvoja, të njihen me metodat e reja të mësimdhënies dhe për të fituar miq dhe kontakte të reja.

Tema e garës për vitin 2015: "Solidariteti"

ACES synon të krijojë një shoqëri ku njerëzit kujdesen për njëri tjetrin, e jo vetëm për vetveten dhe te afërmit e tyre, dhe ku ata jo vetëm që kërkojnë të drejtat e tyre, por janë të vetëdijshëm dhe për përgjegjësitë e tyre për të mirën e të gjithëve. Meqenëse solidariteti aktiv është i një rëndësie të madhe për kohezionin shoqëror dhe për një botë më të qëndrueshme, **tema e thirrjes së ACES për 2015 është "Të inkurajojmë solidaritetin: Kujdesemi për të tjerët dhe ndajmë atë çfarë kemi"**.

Në projekt mund të marrin pjesë të gjitha shkollat fillore dhe të mesme në vend, respektivisht nxënësit **nga 12 deri 17 vjet**.

Kandidatët e interesuar duhet të aplikojnë jo më vonë se 15 prill 2015, ora 24:00. Projektet më të mira do të shpërblehen dhe fituesit do të kenë mbështetje në realizimin e projektit.

Gjuha e punës është gjuha angleze, kurse midis vendeve pjesëmarrëse, përveç Kosovës, janë edhe: Shqipëria, Austria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Republika e Çekisë, Hungaria, Maqedonia, Moldavia, Mali i Zi, Rumania, Serbia, Republika e Sllovakisë dhe Sllovenia.

ACES është iniciativë e Fondacionit ERSTE dhe organizohet nga Interkulturelles Zentrum (Vjenë), në bashkëpunim me VČELÍ DOM (Bratislavë) dhe mbështetet nga Ministritë e Arsimit të të gjitha vendeve pjesëmarrëse.

Informacione shtesë: www.aces.or.at

Information and Contact:

Interkulturelles Zentrum, Vienna, Austria

Rebecca Zeilinger

T: +43 (0) 1 5867544-43

Rebecca.Zeilinger@iz.or.at

Links:

ERSTE Foundation: www.erstestiftung.org

Interkulturelles Zentrum: www.iz.or.at

VČELÍ DOM: www.vcelidom.sk

